


# PRANVERË NË



# ZEMRAT TONA

## ZGJEDHJET DEMOKRATIKE

LEONARD (11), KASTRIOT (12), EDISON (11), BLEART (12), ALINA (12), BLEONA (12)



**Jetojmë në një vend demokratik, sepse jemi të lirë të zgjedhim atë që duam. Ne si fëmijë jemi të lumtur për të drejtat që kemi. Për ta kuptuar se sa të lumtur jemi, lexoni artikullin**

Në demokraci vendimmarrja i takon popullit. Kurse, liria e zgjedhjes është një nga elementet më të rëndësishme të demokracisë.

Në jetën tonë të përditshme ne hasim në shumë situata, kur ne duhet të zgjedhim gjëra të ndryshme. Për shembull, disa nga ne e pëlqejmë shumë futbollin. Për të luajtur futboll i zgjedhim lojtarët, të cilët do të kenë role të ndryshme në fushë. Në rastet e tjera kur dëshirojmë të shkojmë të vizitojmë një vend të caktuar, ne përdorim edhe votën e hapur.

Në një ditë gjatë fundjavës, një grup shokësh dëshironin t'i vizitonin vendet që i pëlqenin. Por, ata kishin mendime dhe preferenca të ndryshme. Disa dëshironin të shkonin në Prizren, disa në Gjiilan, e disa në Gjakovë. Kështu ata votuan. Për shkak që Prizreni mori më shumë vota se vendet e tjera, atë ditë shkuan në Prizren. Pastaj, ka edhe shumë raste të tjera, ku ne fëmijët mund të zgjedhim.

Në demokraci, zgjedhjet si proces, ku qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, kanë rëndësi të madhe, sepse ata marrin vendime të cilat ndikojnë në jetën e secilit. Prandaj, ne duhet t'i mbushim 18 vjet, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke votuar përfaqësuesit e vendit.



Grupi „Talentët“


# TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË TONA

ALBUNIT (11), LEART (11), DENIS (11), LORESA (12), ALBION (13), RINESA (12)



**Ne kemi mësuar sot disa mënyra se si mund të japim kontributin tonë në vendin tonë. Mësoni edhe ju për këto mënyra**

Një ditë në klasë na erdhi një ide. Meqenëse klasa jonë është shumë e dashur për ne, menduam të zbukuronim muret e saj me punime dhe fotografi tonat. Por, diçka nuk na pëlqeu. Ngjyra e mureve të klasës sonë



ishite zbehur. Kishte kohë që klasa jonë nuk ishte lyer. Kështu ne erdhëm në një përfundim. Do ta lyenim ne klasën tonë. Në këtë mënyrë, ambienti do të jetë më i pastër, klasa do të duket më bukur, por edhe nxënësit të cilët do të vijnë pas nesh, do ta gëzojnë punën tonë. Kështu u mbledhëm një ditë, ngjyrosëm klasën dhe në fund u ndjemë tejet krenarë me punën tonë. Klasa jonë doli njëra ndër klasat më të bukura.

Pasi përfunduam me ngjyrosjen dhe zbukurimin, të gjithë mësuesit u habitën nga puna që bëmë.

I gjithë ky aktivitet na bëri neve mirë edhe ambienti tanimë është i pastër.


Kjo që kemi bërë ne është punë vullnetare. Kjo do të thotë se jemi aktivizuar për të mirën tonë dhe të tjerëve. Të tilla punë mund të bëni edhe ju duke u bërë aktiv në shkollën, lagjen apo qytetin tuaj. Aktiv mund të jeni edhe duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, pasi të keni arritur moshën e duhur duke nënshkruar peticione, duke qenë pjesëmarrës në tubime publike apo protesta paqësore, etj. Si qytetarë ne kemi gjithashtu përgjegjësi të votojmë, ta ruajmë ambientin dhe pronat publike, të respektojmë ligjin dhe njëritjetrin, etj. Përpos përgjegjësiwe kemi edhe të drejta. Disa nga to janë: e drejta e shkollimit, e votës, e familjes, e shprehjes së lirë, etj.

Shtetin tonë e mbajmë ne, qytetarët aktiv. Andaj, të aktivizohemi që të kemi shtetin më të mirë në botë.




**Të lumtur që jemi pjesë e demokracisë**





E drejta e shkollimit është e mbrojtur me ligj. Kjo do të thotë se të gjithë kemi të drejtë të shkojmë në shkollë dhe të arsimohemi. Mirëpo, ne gjithashtu kemi edhe përgjegjësi. Për shembull, të respektojmë rregullat e komunikacionit




Në Kuvend kemi 120 përfaqësues. Ata zgjedhen përmes votave tona dhe marrin vendime në emrin tonë. Kjo është arsyeja pse deputetët janë kaq të rëndësishëm për ne. Ata pa votat tona nuk mund të bëhen dot përfaqësues



Të jesh i barabartë në demokraci nënkupton të mos diskriminohesh. Gjithashtu, nënkupton se të drejtat tua nuk do të shkelen për asnjë arsye. Pra, barazia është element kyç në demokraci. Të gjithë duhet të trajtoheni në mënyrë të barabartë

## INSTITUCION ME PLOT VLERA

ERVIS (11), ARBIN (11), KADRI (12), SHEFQET (12), ALBINA (12), ANITA (12)



**Kuvendi është institucion me plot vlera të mëdha, sepse zgjedhet nga populli dhe përfaqëson popullin**

Në këtë artikull do të mundohemi të japim përgjigje në këto dy pyetje: „Pse populli duhet të jetë i kujdesshëm në zgjedhjen e deputetëve?“ si dhe „Pse duhet të ketë deputetë nga komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Kosovës?“ Për këto informata, lexoni më poshtë. Sipas nesh, populli duhet të jetë shumë i kujdesshëm



Mësojmë dhe flasim për Kuvendin

në zgjedhjen e deputetëve, sepse pikërisht deputetët janë ata të cilët marrin vendimet më të rëndësishme për ne. Pa punën dhe përkushtimin e tyre, nuk do të ishte i mundur i tërë ky strukturim i jetës sonë. Vetë fakti i miratimit të ligjeve nga ana e deputetëve, e dëshmon rëndësinë dhe ndikimin e punës së tyre tek ne qytetarët. Prandaj, ne flasim lirshëm, lëvizim lirshëm dhe marrim pjesë në vendimmarrje, kur vie koha e

paraparë me ligj. Nga hyrja në fuqi e ligjeve, të gjithë trajtohemi në mënyrë të barabartë. E kur jemi tek barazia, duam të ndërlihem tek numri i deputetëve nga komunitetet jo shumicë, të cilët punojnë në Kuvend. Kjo nënkupton se Kuvendi ka frymë demokratike dhe i pranon të gjithë pa asnjë lloj dallimi. E pikërisht vlerë qenësore e demokracisë është diversiteti.

Vlen të theksohet se nëse ne kemi dëshirë për të kandiduar në të ardhmen për deputetë, e kemi këtë liri dhe këtë të drejtë, sepse demokracia na jep këtë mundësi të mrekullueshme.

Andaj, ju ftojmë që të jeni shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit. Gjithçka nis nga ne, sepse fuqia është në duart tona. E kjo fuqi kalon nga dora në dorë dhe të gjithë kanë mundësinë ta ndjejnë efektin e fuqisë që e gëzojnë. Vetëm me një votë, vendoset gjithçka. E ti mund të jesh ai/ajo që vendos. Bëhu i kujdesshëm!



Grupi i mençur





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Sadri Duhla“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Suharekë